REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 448/26 Dt. 22.09.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Vendimit 001-011 nr. 66126, të datës 02.06.2026 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR PAGESË TË SHËRBIMEVE PËR TRANSPORTIN URBAN

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për subvencionimin e shërbimeve për transport urban në Komunën e Prizrenit të cilat do të llogariten në bazë të rendeve të udhëtimit e të cilat janë të vërtetuar nga organi kompetent, kështu që, për qëllim dhe në emër të pagesës së shërbimeve për transportin urban të lartcekur, lejohen mjetet financiare në vlerë prej 1.20 € (një euro e njëzet cent) për kilometër (€/km).

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Vendimi 001-011 nr. 66126, të datës 02.06.2026, të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.